



Ludothèque d'Onex : Rregullat e përdorimit

Jemi të kënaqur të ju presim ju dhe fëmijët tuaj në dhomën e lojrave të Onexit.

Me regjistrimin e juaj, bëheni anëtarë të shoqatës sonë.

Bashkëpunimi dhe dashamirësia juaj, si anëtarë, mund ta përmirësojë cilësinë e shërbimit që ne dëshirojmë të ju ofrojmë.

1. Përkufizim i përgjithshëm i pajimit “qender huadhenëse lojerash”. Ludotekë.

Nje Ludotek është nje shoqate me qellim jo fitim-përfitues.

Ashtu siç është nje bibliotekë që jep libra ne huazim, ashtu edhe një ludoteke jep lodra me hua dhe kushte te volitshme.

Personeli i ludotekës punon vullnetarisht me përjashtim të dy përgjegjësve që janë të shpërbluar.

2. Cfarë mundsi të ofron ludoteka?

Qendra jone jep lodra në huazim.

Duhet te bëheni anetar që të keni mundesi të merrni lodra, *gjithashtu* është e mundur që të luhet në lokalet e ludotekës.

Fëmijet duhet të jenë nën pergjegjësinë dhe mbikqyrjen e prindërve ose te shoqëruesit të tyre.

Fëmijët nuk duhet ti nxerrin lodrat jashtë raftëve nga dhoma pa pajtimin e një të rrituri (prindit ose personit i cili mbikqyrë në ludotek).

3. Sa kushton huazimi ?

Shuma vjetore për një familje është deri në **CHF 40-** për banorët e Komunave të subvencionuara (Onex, Confignon dhe Bernex), dhe **CHF 50.-** për të tjerët. Për klasa parashkollore, për shoqatat dhe personat jashtë komunës antarsimi është vjetor është **CHF 100.-**

Shpenzimet e huazimit përfshihen në pagesën vjetore, përveç gjatë verës.

4. Sa lodra është e mundur ti merrni në huazim ?

Mund ti merrni në huazim më së shumti 5 lodra për një familje

Prinderit e pranojnë nje kartën e antarsimit.

I lutemi përdoruesit që të na lajmrojnë në rast te ndrrimit të adresës.

5. Sa kohë mund ti mbani lodrat e huazuara?

Huazimi i lojrave është deri në deri ne 4 jave.

Cdo tejkalim (vonesë) i një jave më shumë, paguhet CHF 1.- për çdo lodër të huazuar.

P.sh. nëse jeni vonuar një jave dhe i keni tri lodra paguani CHF 3.-

Zgjatja e huazimit të lojrave është mundur për 1 jave por vetem nje herë.

Shuma e mbledhur është e destinuar për blerjen periodike të lodrave dhe lodrat që janë në dispozicion.

6. Kthimi i lodrave/ kontrolli.

Para huazimit të lodrave, përdoruesi duhet vet ti kontrolloj të gjitha lodrat nëse janë në rregull, të pastra e të gjitha në numër siç shkruan.

